



KONGRESI
RINOR
KOMBËTAR

FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG



Përmet

PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR RININË 2020-2023

- Përmet -

Planet
Lokale të
Veprimit

Jeta Qytetare Tënd





Jeta Qytetin Tënd

Përmbajtja

I. QËLLIMI DHE METODOLOGJIA


1.1 Qëllimi.....	06
1.2 Metodologjia	07
1.3 Parimet Udhëheqëse	09

II. BASHKËRENDIMI ME POLITIKAT VENDORE, KOMBËTARE DHE EUROPIANE 10

III. ANALIZA E SITUATËS AKTUALE DHE PLANIFIKIMI 12

IV. ANALIZA SWOT 19

V. MONITORIMI DHE VLERËSIMI 19



**PËR REALIZIMIN E KËTIJ
PLANI LOKAL VEPRIMI PUNUAN:**

Koordinator Lokal dhe Hartues:

Dorjan Meraj

CESVI Albania, Përmet.

Ekspert Lokal:

Elidjon Thanasi,

Vjosa Explorer, Përmet.

Pikë kontakti Bashkia:

Aulona Meshini

Zv. Kryetare e Bashkisë Përmet.

**Koordinimi në nivel kombëtar dhe asistimi në
hartim:**

Sekretariati i Kongresit Rinor Kombëtar:

Dafina Peci,

Drejtoreshë Ekzekutive.

Korrektim dhe Kurim:

Shila Parllaku,

Oficere Komunikimi

Falenderime

Plani Lokal i Veprimit për Rininë u bë i mundur falë mbështetjes së plotë të Fondacionit Friedrich Ebert, i cili mbështet zhvillimin e politikave rinore në nivel vendor dhe qendror, në bashkëpunim me Kongresin Rinor Kombëtar.

Puna e zhvilluar në nivel kombëtar për planet e veprimit 2020-2023 në 12 Bashki ka pasur synim nxitjen e dialogut të strukturuar rini-institucione, në bazë të një metodologjie dhe rrugëtimi të njehsuar, në bashkëpunim të ngushtë me organizatat aktive të Kongresit Rinor Kombëtar dhe me gjerë, të rinj nga shkollat e mesme dhe universitetet, si dhe me mbështetjen e madhe dhe angazhimin sistematik të Bashkive.

Këto plane do shërbejnë si një bazë orientuese politikash dhe veprimtarie të dedikuar për sektorin e rinisë, në përputhje të plotë me perceptimet dhe vizionin që të rinjtë dhe institucionet kanë mbi perspektivën lokale.

Një falenderim shkon për të gjithë ata që u bënë pjesë dhe kontribut në këtë rrugëtim!

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Bashkia Përmet me mbështetjen e Fondacionit Friedrich Ebert në bashkëpunim me Kongresi Rinor Kombëtar ka hartuar Planin Lokal të Veprimit për Rininë, dhe nëpërmjet këtij dokumenti prezanton përpjekjen e saj më serioze për të ndërhyrë thellë e në mënyrë gjithëpërfshirëse për transformimin e realitetit ku jetojnë, studiojnë dhe ëndërrojnë të rinjtë e qytetit.

Vizioni ynë për vitet e ardhshme projekton krijimin e kushteve dhe një mjedisi të sigurt social, shëndetësor dhe politik, për një rini aktive dhe të barabartë në të gjitha fushat e jetës dhe me status të konsoliduar për të ardhmen e tyre. Prioritet do të jetë përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së jetës së të rinjve dhe forcimi i statusit të tyre, përmes zhvillimit të më shumë mundësive në edukim, punësim, shëndetësi, kulturë dhe rritjen e pjesëmarrjes së plotë të të rinjve në shoqëri dhe vendimarrje.

Gjashtë shtyllat kryesore mbi të cilat

bazohet SVR janë pjesë integrale e “Strategjisë Europiane për të Rinjtë 2019-2027” dhe në koordinim të plotë me të gjithë dokumentat strategjike në nivel qendror dhe vendor. Në evindentimin e këtyre shtyllave rol të rëndësishëm patën analiza e situatës aktuale dhe analiza SWOT e të gjithë fushave që janë kompetencë e Bashkisë. Potencialet dhe problematikat e evidentuara janë ndërthurur dhe kombinuar duke formuluar këto objektiva:

Arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës adreson mangësitë fizike dhe materiale, si edhe vështirësinë e aksesit në institucione edukuese, për shkak të aftësive, përkatësisë në një grup vulnerabël apo të marginalizuar etj. Ky prioritet përmbledh dhe adreson të gjitha nivelet e arsimit në territorin e Bashkisë Përmet. Objektivat dhe masat për këtë prioritet janë ndërtuar duke marrë në konsideratë mundësitë ekzistuese për zgjidhjen e këtyre problematikave dhe, njëkohësisht, duke parashtruar masa që mund të ndërmerren drejt zgjidhjes.

Punësimi dhe sipërmarrja rinore përfshin dhe adreson papunësinë e të rinjve (duke përfshirë sidomos angazhimet sezonale ose studentore), efektshmërinë dhe zbatueshmërinë e politikave që janë në fuqi, vetëpërfshirjen e të rinjve dhe palëve të treta në organizata të shoqërisë civile, organizata ndërkombëtare e më tej.

Pjesëmarrja dhe përfaqësimi rinor merret drejtpërdrejtë me përfaqësimin e të rinjve për të marrë pjesë në Këshillin Bashkiak si organ përfaqësues i Bashkisë, me mundësitë dhe motivimet e të rinjve dhe të rejave për të marrë pjesë drejtpërdrejtë në politikëbërje dhe vendimmarrje në Bashkinë Përmet. Në këtë kontekst, për të arritur në konkretizimin e masave të sugjeruara, janë analizuar nisma të mëparshme dhe efektshmëria e tyre, si edhe janë marrë në konsideratë nisma ekzistuese.

Art, sport, kulture dhe mjedisi përfshin dhe adreson kohën e lirë, nevojën argëtim dhe promovimin e të rinjve virtuoze dhe të talentuar adreson cilësinë e jetës së shëndetshme dhe një qytet me ajër të pastër, nxitjen dhe zhvillimin e turizmit. Masat janë orientuar drejt krijimit të hapësirave, aktiviteteve, programeve, mundësive kulturore, hapësirave për të

ushtruar sportin, për të bërë art dhe aktivitete të tjera krijuese dhe argëtuese.

Mbështetja e organizatave dhe nismave rinore qytetin e Përmetit parashikon jo vetëm një përjasje mbështetëse nga ana e Bashkisë Përmet, por edhe një ndërveprim aktiv, në mënyrë që të ketë sa më shumë nisma cilësore nga ana e të rinjve. Për këtë, prioritetet dhe masat janë orientuar drejt mundësive financiare dhe aktiviteteve konkrete që ndihmojnë organizatat grupimet dhe nismat rinore, në mënyrë që të funksionojnë si duhet dhe të kenë qëndrueshmëri.

Çështjet sociale, shëndetësore dhe shërbimet publike për të rinjtë përfshijnë një gamë të gjerë shërbimesh dhe lehtësirash që të rinjtë përfitojnë për shkak të grupmoshës në të cilën ata bëjnë pjesë. Realizimi i këtyre shërbimeve dhe përfitimi që do të kenë të rinjtë, do të sillte përmirësimin e gjendjes dhe mirëqënies së tyre në qytet dhe, për rrjedhojë, mirëfunksionimin e tyre efektiv si qytetarë të kësaj Bashkie.

1.1 QËLLIMI

Dinamikat qeverisëse në Shqipëri po orientohen gjithnjë e më shumë drejt hartimit dhe zbatimit të politikave në nivel vendor, kjo në vazhden e decentralizimit të pushtetit qendror dhe mbështetjes së autonomisë së Njësive të Qeverisjes Vendore (NjQV) për përmbushjen e funksioneve të përcaktuara me ligj. Politikat dhe dokumentat strategjike sektoriale janë instrumenta të nevojshëm për të udhëhequr sektorë të veçantë, në përputhje të plotë me funksionet dhe kuadrin ligjor.

Qëllimi i këtij Plani Veprimi është hartimi i një platforme strategjike dhe gjithëpërfshirëse që do të nxisë zhvillimin e një rinie të kulturuar dhe të shëndetshme, që mund të luajë një rol aktiv në demokratizimin dhe zhvillimin ekonomik vendor. Në veçanti, pjesëmarrja e rinisë në jetën publike dhe forcimi i statusit socioekonomik të saj përbëjnë një domosdoshmëri për arritjen e standardeve europiane dhe një ekonomie tregu të aftë për t'u përballur me sfidat e globalizimit.

Plani Lokal i Veprimit frymëzohet nga vizioni european mbi angazhimin qytetar, forcimin ekonomik, mbrojtjen sociale dhe zhvillimin kulturor të të rinjve në Bashkinë Përmet. Përparësitë e angazhimit strategjik synojnë

shfrytëzimin optimal të burimeve në dispozicion dhe një bashkërendim të punës jo vetëm ndërmjet strukturave të Bashkisë Përmet që kontribuojnë në zhvillimin e rinisë por edhe bashkërendimin e punës së institucioneve në të gjitha nivelet e qeverisjes. Në fokus do të jetë dhe krijimi i sinergjive nëpërmjet bashkëpunimit me shoqërinë civile, organizatave ndërkombëtare dhe bizneseve.

Strategjia synon që të nxisë aktivizmin rinor dhe rritjen e kapaciteteve për të rinjtë në mënyrë që ata të kenë më shumë mundësi dhe hapësira në të ardhmen. Bazuar gjithashtu në qëllimin dhe objektivat e "Strategjisë Europiane për të Rinjtë 2019-2027", strategjia vendore për të rinjtë synon që të bashkojë të rinjtë për ndërtimin e një qyteti pa barriera, duke e kthyer kështu qytetin në një hapësirë të dedikuar për brezat e rinj.

**Planet
Lokale të
Veprimit**
Jeta Qytetin Tënd



1.2 METODOLOGJIA

Studimi është realizuar në nivel kombëtar dhe shtrirë në 12 bashki në fokus, ku 10 prej tyre janë bashki qender qarku. Ai është konceptuar të realizohet në disa faza, të përcaktuara dhe detajuara në vijim. Realizues dhe Zbatues të studimit do të jenë KRK dhe rrjeti i organizatave nëpërmjet koordinimit dhe punës në terren nga 12 koordinatorët lokal.

Për çdo Bashki, do të jetë 1 koordinator lokal në bashkëpunim me subjektet pjesë e rrjetit të KRK, e cila është përgjegjëse për realizimin në terren të studimit dhe për përfshirjen e gjetjeve nga studimi në Planet Lokale të veprimit sipas secilës Bashki përkatësisht. Thëksojmë se studimi është realizuar në të gjithë territorin në mbulim të Bashkisë respektive, pra duke konsideruar edhe ish-komunat, sot njësitë Administrative.

Studimi është i ndarë në **këto faza:**

1. Faza e parë është **krijimi i backgroundit të Research Topic** (Nevoja e hartimit të planeve lokale të veprimit për rininë). Kjo fazë përfshin:

- Hulumtimi në literaturën (Praktikat në Rajon dhe Rregullimet Ligjore përkatëse)
- Përcaktimi i metodologjisë së kërkimit
- Përcaktimi i kuadrit teorik (Legjitimimi i kërkimit) dhe karakteri aplikativ i tij (përse na duhet? Dhe çfarë na sjell?)

2. Faza e dytë është **mbledhja e të dhënave**

cilësore: : të tipit të raporteve; të dhënave të publikuara për situatën e të rinjve në nivel vendor për 6 fushat e përcaktuara. Kjo fazë përfshin:

- Evidentimi i të gjitha problematikave që lidhen me informacionin/informimin e të rinjve për hapësirat/mundësitë reale të përfshirjes dhe angazhimit të tyre në 6 fushat prioritare të përcaktuara.

- Evidentimi i raportit buxhet i parashikuar-buxhet i shpenzuar për aktivitete dhe zbatimin e politikave rinore (Ballafaqimi i kërkesave/nevojave të Ri (e)-Pushtet Vendor).

- Përcaktimi i nevojave dhe prioriteteve komunitare e lokale sipas secilës fushë që Plani Lokal i Veprimit mendohet të përfshijë.

- Kapacitetet e pushtetit lokal dhe për përmbushjen e kërkesë-nevojave komunitare për të rinjtë.

3. Faza e tretë ka të bëjë me skicimin e Research Design-it nga secila Organizatë për secilën Bashki përkatësisht, sipas vendit ku ato operojnë:

- Formulimi i Hipotezës;
- Formulimi i Pyetjeve Kërkimore;
- Nxjerrja e Implikimeve;
- Nxjerrja e Indikatorëve/treguesve për Studimin.

4. Faza e katërt ka të bëjë me përcaktimin e të dhënave të tilla si:

- Lloji i kampionimit që do të përdoret/ si? Dhe ku? do të mblidhen të dhënat.
- Sa persona do të pyeten/madhësia e kampionimit në nivel kombëtar.
- Nga cilat grupmosha do të nis studimi.
- Sa persona do të pyeten për secilën bashki.
- Listimi i indikatorëve/ përkthimi i tyre në pyetje.
- Cilat alternativa nxjerrin më në pah problemin kërkimor (Mangësitë e konstatuara në nivel lokal specifikisht, evidentimi i nevojave, identifikimi i prioriteteve sipas objektivave strategjike për planet lokale të veprimit).

Kjo fazë është e përbërë nga këto etapa:

- Skicimi i Kampionimit - kjo do të bëhet secifikisht për secilën Bashki në program.
- Hartimi i pyetësorit - bazuar në indikatorët për 6 fushat prioritare për të rinjtë.
- Pre-testimi i Pyetësorit - (sa i kuptueshëm dhe i realizueshëm është për t'u arritur). Evidentimi dhe reflektimi i ndryshimeve/

draftimi final i pyetësorit.


5. Faza e pestë ka konsistuar në realizimin në terren të procesit të anketimit (2400 pyetësorë gjithsej) dhe mbledhja e të dhënave sasiore. Kjo fazë u zhvillua në 2 muaj, ku puna në terren me pyetësorët zgjati një javë të plotë dhe u angazhuan në terren 12 koordinatorët lokal me ndihmesë nga vullnetarë dhe asistues sipas nevojës.

6. Faza e gjashtë është checkimi i pyetësorëve dhe hedhja e të dhënave. Krijimi i një baze të plotë të dhënash në excel.

7. Faza e shtatë është përpunimi statistikor (frekuenca dhe crosstabe) i të dhënave në SPSS sipas implikimeve të përcaktuara në fazën e tretë.

8. Faza e fundit është përpilimi i raportit me gjetjet, përfundimet, dhe rekomandimet përkatëse.

9. Hartimi i Planeve Lokale të Veprimit për secilën Bashki, bazuar në procesin e mësipërm.



PARIMET UDHËHEQËSE

Parimet të cilat kanë udhëhequr procesin e hartimit të PLR-së, janë edhe parimet mbi të cilat Bashkia Përmet synon të ndërtojë të ardhmen e qytetit me qytetarët. Më konkretisht këto parime konsistojnë në:

Zhvillimi i qëndrueshëm: Ky parim ka udhëhequr gjithë procesin e hartimit të PLVR-së dhe udhëheq njëherazi gjithë strategjitë kryesore kombëtare, rajonale dhe vendore. Pra është e rëndësishme që shfrytëzimi i burimeve të bëhet në mënyrë sa më të balancuar dhe nëpërmjet një planifikimi të integruar për të arritur zhvillim ekonomik dhe social që garanton qëndrueshmëri në kohë dhe jetëgjatësi. Ky parim është thelbësor kur flitet për të ardhmen e rinisë, motorrit kryesor të shoqërisë shqiptare.

Subsidiariteti: Strategjia është hartuar duke pasur parasysh që ushtrimi i përgjegjësiave publike duhet në mënyrë të përgjithshme, t'iu takojë më tepër autoriteteve të cilat janë më pranë qytetarëve ku dhe impakti është më i madh. Bashkia Elbasan që prej vitesh ka pasur në fokus të veçantë rininë nisur edhe nga fakti se zhvillimi dhe integrimi i të rinjve është cilësuar gjithmonë si guri i themelut të një shoqërie të fortë.

Bashkërendimi: Kjo strategji ka synuar të koordinohet me kuadrin strategjik të zhvillimit të Bashkisë Elbasan, duke ndjekur objektivat dhe parimet thelbësore të zhvillimit të përcaktuara në dokumentat strategjike vendore. Në të njëjtën

mënyrë, PLVR është përpjekur të jetë në harmoni me interesat e shoqërisë civile dhe organizimeve rinore duke promovuar forma të ndryshme bashkëqeverisjeje apo bashkëpunimi për një zhvillim të qëndrueshëm. Përpjekjet e organizuara të të gjithë niveleve qeverisëse të mbështetura edhe nga organizatat rinore do të fuqizojnë rolin e të rinjve në të gjitha fushat.

Llogaridhënia dhe Transparenca: Qëllimet dhe objektivat strategjike, të përcaktuara në këtë strategji janë përkthyer në projekte dhe aktivitete specifike të matshme nëpërmjet treguesve të performancës, duke i bërë këto objektiva lehtësisht të matshme dhe të monitorueshme.

Gjithëpërfshirja: Strategjia ka patur në fokus kryesor filozofinë e gjithëpërfshirjes sociale duke u përpjekur në trajtimin e problematikave kryesore të çdo grupi social, me një vëmendje të lartë ndaj grupeve të marginalizuara të shoqërisë. Kjo nënkupton, krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë të rinjtë e Bashkisë Elbasan duke i ndihmuar ata në arritjen e mirëqënies së përbashkët.

Fleksibiliteti: Duke marrë në konsideratë reformat e shumta që Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë gjatë pesë viteve të fundit dhe ndryshimet thelbësore që kanë prekur funksionet dhe kompetencat e NJQV-ve, strategjia është hartuar në mënyrë të tillë që të lejojë hapësirat e nevojshme për t'iu përshtatur kontekstit politik ende në ndryshim e sipër. Kjo do të thotë se objektivat strategjike dhe projektet janë hartuar duke marrë parasysh disa skenarë zhvillimi për të arritur përmbushjen më optimale të tyre përgjatë kësaj periudhe tranzicioni

BASHKËRENDIMI ME POLITIKAT VENDORE, KOMBËTARE DHE EUROPIANE

Vizioni i këtij dokumenti orientues e strategjik për tre vitet e ardhshme kërkon vendosjen e rinisë në fokus të jetës aktive të qytetit nëpërmjet mbështetjes së partneritetit dhe nxitjes së bashkëpunimit me të rinjtë e vendeve europiane. Në mënyrë që të realizohet ky vizion afat-mesëm, është parësore që të bashkërendohet me planet kombëtare afat-mesme dhe afat-gjata dhe të ketë koordinim më efikas me organizatat rinore dhe aktorët e tjerë të përfshirë në këtë proces. Mungesa për një kohë të gjatë e kuadrit ligjor për rininë ka bërë që përfshirja e të rinjve në jetën publike, vendimmarrje politike dhe shërbimet e dedikuara për rininë të jenë në vullnetin e titullarëve të institucioneve publike. Mungesa e kuadrit ligjor ka bërë që edhe bashkëpunimi jo vetëm ndërinstitutional por ndërmjet rrjetit të shoqërisë civile dhe organizatave rinore të jetë i pastruktuar dhe nuk përfshin të gjitha aspektet ku përfshihet rinia. Prandaj gjatë procesit të hartimit të Planin Lokal të Veprimit të Rinisë 2020-2023 janë marrë në konsideratë objektivat e politikave dhe planeve kombëtare, rajonale dhe vendore për të krijuar një kuadër zhvillimor më

koherent dhe të qëndrueshëm dhe sa më pranë standardeve të Bashkimit European (BE).

Në nivel ndërkombëtar:

>>> Strategjia e BE-së për Rininë, e cila advokon fuqishëm për “punën e të rinjve” një koncept holistik që shkon përtej punësimit dhe mbulon aspekte të ndryshme të zhvillimit personal të të rinjve. Siç është përcaktuar në Strategjinë e Rinisë të BE-së, ka të bëjë me “fuqizimin, emancipimin, përgjegjësinë dhe tolerancën...”.

>>> Strategjia Europa 2020 ka qëllim nxjerrjen e 20 milion njerëzve nga varfëria, luftën ndaj përjashtimit social dhe forcimin e punësimit. Iniciativat kryesore nën këtë strategji janë Platforma kundër Varfërisë dhe Përfshirjes Sociale dhe Axhenda për Aftësi të reja dhe Vende pune.

>>> Strategjia e Përfshirjes Sociale BE 2015-2020 është në thelb të Planit Kombëtar të Veprimit për Përfshirjen Sociale 2007-2016, e cila përcakton mekanizmat dhe strategjitë për përfshirje sociale gjatë ciklit të jetës së individëve si: fëmijët, individët në moshë pune, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuar dhe komunitetet. Për më tepër, është mbështetur nga programi i Progresit, një instrument financiar që ka për qëllim zhvillimin e politikave në 5 fusha strategjike: punësimi, mbrojtja dhe përfshirja sociale, kushtet e punës, anti-diskriminimi dhe barazia gjinore.



Në nivel kombëtar:

>>> Programi i Qeverisë 2017-2021 Ky program në seksionin e rinisë, parashikon hartimin e politikave për përmirësimin e cilësisë së jetës, rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën politike, programe dhe projekte për nxitjen e punësimit, krijimin e një kuadri ligjor të qartë për rininë ku përcaktohen qartë kompetencat e niveleve të ndryshme të qeverisjes lidhur me përgjegjësitë që kanë ndaj të rinjve, si dhe forcimin e rrjetit të bashkëpunimit ndërmjet aktorëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

>>> Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020 (SKZHI) përcakton një qasje të integruar për zhvillimin socio-ekonomik të vendit po ashtu dhe për integrimin në BE. Impakti që kjo strategji kërkon është në 3 këndvështrime: së pari, një zhvillim ekonomik më i madh përmes rritjes së tregut të punës, forcimit të arsimit – duke përfshirë arsimin dhe trajnimin profesional, vullnetarizmin dhe minimizimin e ekonomisë informale. Së dyti, ka qëllim shndërrimin e rritjes ekonomike në mirëqenie sociale, përmes investimit në shërbime publike që ndihmojnë përfshirjen, kohezionin dhe cilësinë e jetës. Aksi i tretë i strategjisë bazohet në fuqizimin e qeverisjes, demokracinë dhe parametrat e ligjit të së drejtës.

>>> Strategjia për Punësim dhe Aftësi 2013-2020 ka qëllim ndërtimin e një fuqie punëtore më të arsimuar dhe të aftë sipas nevojave të tregut të punës. Politikat prioritare të identifikuar janë: a) forcimi i mundësive të punësimit përmes politikave efektive të tregut të punës, ku ofrimi i sa më shumë mundësive për të rinjtë është një prioritet; b) ofrimi i arsimit dhe trajnimit profesional cilësor dhe trajnimit

të të rinjve dhe të rriturve; c) nxitja e përfshirjes sociale dhe kohezionit territorial; dhe d) forcimi i qeverisjes së tregut të punës dhe sistemit të kualifikimeve.

>>> Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2015-2020 – harton një plan për ndërtimin e një sistemi të mbrojtjes sociale ku individët fuqizohen dhe grupeve vulnerabël iu ofrohen oportunitete që i bëjnë ata më shumë autonomë shoqëruar kjo me mekanizmat parandalues dhe të ri-integrimit në shoqëri.

>>> Plan i Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020 – Ky plan ka për qëllim hartimin e politikave të tërthorta për integrimin e plotë të të rinjve në skemën e shëndetësisë, arsimit, punës sociale dhe pjesëmarrjes politike me qëllim që ata të bëhen anëtarë aktiv të shoqërisë në të gjitha aspektet. Ky plan veprimi është bazuar në 6 objektiva strategjik si: Nxitja e të rinjve dhe pjesëmarrja e tyre në proceset demokratike/vendimmarrje; Nxitja e punësimit të të rinjve përmes politikave efektive të tregut të punës; Shëndetësia; Sporti dhe Mjedis; Arsimi i të rinjve; Mbrojtja sociale; Kultura dhe Vullnetarizmi.

>>> Plan Kombëtar Veprimi 2010-2015 për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve - Plan i është bazuar në një qasje të plotë që targeton minoritetet me qëllim përfshirjen e tyre. Kështu, politikat variojnë nga shërbime bazike si shëndetësia, arsimi, punësimi dhe strehimi; në shërbime më të sofistikuara si mbrojtja e trashëgimisë kulturore.



MATRICA E BASHKËRENDIMIT ME DOKUMENTAT STRATEGJIKE NDËRKOMBËTARE, KOMBËTARE DHE VENDORE

DOKUMENTET STRATEGJIKE	OBJEKTIVAT E STRATEGJISË VENDORE PËR RININË				
	MBËSHTETJA SOCIALE DHE BARAZIA GJINORE	EDUKIMI JO FORMAL DHE REKREACIONI	MBËSHTETJA FINANCIARE DHE NXITJA E PUNËSIMIT	HAPËSIRAT DHE INFRASTRUKTURA RINORE	PERFAQËSIMI, PJESEMARJJA DHE INTEGRIMI NË BE
Strategjia e BE-së për Rininë					
Strategjia Europa 2020					
Strategjia e Përfshirjes Sociale BE 2015-2020					
Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015-2020					
Programi i qeverise 2017 – 2021					
Pakti për universitetet					
Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014 - 2020					
Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2015 – 2020					
Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015 - 2020					
Plani Kombëtar Veprimi për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianë					
Ligji mbi “Barazinë gjinore në shoqëri”					
Plani Operacional i Zhvillimit Vendor Bashkia Përmet					



III. ANALIZA E SITUATËS AKTUALE DHE PLANIFIKIMI

ARSIMI CILËSOR DHE GJITHËPËRFSHIRËS				
SITUATA AKTUALE	OBJEKTIVAT STRATEGJIK	INDIKATORË	AKTIVITETE	FINANCIM
Aktualisht ne shkollat e Bashkisë Përmet ekzistojnë kabinetet e Kimi-Biologji dhe Fizikë por kryerja e eksperimenteve dhe punëve laboratorike është e kufizuar dhe ndikon ne cilësinë e mësimdhënies duke mos përmbushur kriteret dhe kërkesat e kurrikulave të reja. Vihet re një mungesë e madhe në elementet kimik, mikroskopa, epruveta, etj. Në klasat e shkollave janë instaluar këndet e klasave dhe gjithashtu në ambientet e përbashkëta janë të afishuara punë të të rinjve por mungesa e ekspozitorëve rrezikon dëmtimin fizik të ambienteve të shkollave. Shkollat edhe pse kanë hapsira të lira përveç kabineteve që zhvillohen punë laboratorike nuk ka ambiente të tjera rekreative brenda saj në funksion të kreativitetit dhe zhvillimit te aktiviteve. Situatë e sitemeve të ngrohjes në shkollat e Bashkisë Përmet mund të themi se është në nivele të kënaqshme por megjithatë është e nevojshme mirëmbajtja e tyre dhe plotësimi i nevojave dhe duke parë kapacitete dhe mundësitë finaciare të Bashkisë është thuajse e pamundur plotësimi 100% i nevojave. Programet e shkëmbimit midis shkollave janë thuajse inekzistente. Mungojnë projekte dhe programe që të mbështesin vizita studimore, shkëmbime experience ose pjesëmarrje/realizime konkursesh të të rinjve midis shkollave në nivel qarku ose kombëtar.	1. Infrastruktura fizike dhe materiale më e mirë në shkolla. 2. Shkëmbime nëpërmjet shkollave dhe mbështetj e e talenteve.	1. Mbështetja financiare dhe ambientet e ristauruara, numri i pajisjeve dhe materialeve të shtuara në laboratore, orë mësimi të realizuara ne laboratore, numri total i nxënësve që realizojnë orët mësimore në laboratore. 2. Vizita studimore të realizuara, evente me pjesëmarrje nga shkolla të tjera, nxënës pjesëmarrës në konkurse dhe programe shkëmbimi.	1.1 Pajisja e laboratorëve me mjete dhe pajisje të lëndëve specifike. Realizimi i një mapping për të pare mangësitë. Blerja e materialeve plotësuese për laboratorët si element kimik mungues, epruveta, mikroskop, tavolina pune, ekspozitor, kompjutera, material të tjera të ndryshme. 1.2 Plotësimi me materiale i hapësirave rinore ne shkolla duke i dhënë shtysë kreativitetit dhe zhvillimit të aftësive. Si shkak i uljes së numrit të nxënësve janë krijuar shumë hapësira boshe dhe të pa shfrytëzueshme. Plotësimi i këtyre hapësirave dhe pajisja me material si ekspozitorë, tavolina apo material specifike do të sillte impenjimin e të rinjve edhe jashtë orarit mësimor duke i mbajtur larg problematikave sociale dhe duke e kthyer shkollën në qendrën komunitare që të gjithë kërkojnë. 1.3 Mirëmbajtja dhe furnizimi i sistemeve ngrohëse nëpër shkolla. 1.4 Realizim i vizitave studimore në shkolla të Qarkut Gjirokastrë por edhe shkolla në nivel kombëtar. Realizimi i vizitave të kësaj natyre do të sillte një përfitim shumë të madh si për nxënësit edhe për mësuesit. Shkëmbime eksperiencash, shkëmbime metodologjie dhe krijimi i aktiviteve të përbashkëta midis shkollave është elementi që i mungon më së shumti të rinjve në Shqipëri. 1.5 Realizim konkursesh dhe pjesëmarrje në konkurse rajonale dhe kombëtare. Aktualisht realizohen olimpiada dhe konkurse nga Ministria e Arsimit por ky aktivitet parashikon realizimin e nisma nga vet të rinjtë për tu integruar dhe përfshirë në evente sipas konceptimit të tyre.	2.000.000 1.500.000 21.000.000 800.000 500.000

PUNËSIMI DHE SIPËRMARRJA RINORE

SITUATA AKTUALE	OBJEKTIVAT STRATEGJIK	INDIKATORË	AKTIVITETE	FINANCIM
Punësimi është një nga problematikat më kryesore që përballen të rinjtë në Përmet. Zhvillimet e fundit ekonomike kanë sjellë rrijedhimisht jo vetëm krijimin e vendeve të reja të punës por edhe krijimin e profesioneve të reja. Zhvillimi i turizmit dhe i përpunimit të produkteve tradicionale dhe agroushqimore ka sjellë nevojën e ofrimit të shërbimeve të reja por edhe profesioneve si guida natyrore, guida kulturore, përpunues produktesh tradicionale, etj, duke krijuar boshllëqe në fuqi puntore të kualifikuar. Ka pasur përpjekje nga organizata të ndryshme për realizime kursesh formimi profesional por kanë ngelur thjesht si njohuri, të pa formalizuara dhe të pa njohura si kualifikime zyrtarisht nga shteti Shqiptar. Përgatitja dhe kualifikimi i të rinjve nuk është e vetmja problematikë që ata përballen. Aktualisht nuk është ndjekur dhe realizuar asnjë praktikë intershipi apo traineeship megjithëse bizneset lokale por edhe institucionet lokale i kërkojnë dhe i mbështesin këto lloje nismash. Vendosja në praktikë e aftësive të fituara dhe gjetja e mundësive për intership është një nga elementët kyç në promovimin dhe punësimin e të rinjve.	1. Organizimi i kurseve profesionale duke u orientuar sipas tregut lokal të punës. 2. Zhvillimi i Intershipeve dhe i traineeshipeve	1) Kurse formimi profesional të realizuara; numri i të rinjve pjesëmarrës në trajnime. 2) Intershipe dhe traineeshipe të realizuara; numri i bizneseve dhe institucioneve lokale të përfshira në traineeshipe dhe intershipe; të rinj të punësuar pas intershipit.	1.1 Realizimi i kurseve profesionale të njohura dhe të çertifikuara nga Ministria e punës dhe Çështjeve sociale në guida natyrore, guida të sporteve të aventurës, guida kulturore, kuzhinë tradicionale, përpunues produktesh tradicionale, ofrues shërbimesh të mikëpritjes. Përzgjedhja e pjesëmarrësve në këto kurse do të bëhet në bashkëpunim me aktorët lokal duke përcaktuar numrin e të rinjve që do të marrin pjesë në kurse, kurset që do të realizohen si dhe pjesëmarrjen e numrit të të rinjve në çdo kurs. Do të kërkojnë dhe gjenden kurrikulat më bashkëkohore dhe të përshatshme me nevojat lokale si dhe do të impenjohen trainer me eksperience në realizimin e tyre. 1.2 Bashkëpunim me aktorët lokal si hotele, restorante, agjensi turistike, prodhues produktesh tradicionale dhe agroushqimore në mënyrë që pas realizimit të kurseve këta të rinj të impenjohen realisht në aktivitete dhe punë nëpërmjet traineeshipeve dhe intershipeve në këto institucione dhe biznese duke e shprehur veten e tyre dhe përmirësuar aftësitë e fituara gjatë trajnimeve. Në realizimin e sukseshëm dhe eficient të këtyre aktiviteteve është e nevojshme mbështetja e të rinjve duke u paguar sigurimet shoqerore e shëndetsore, të regjistruhen si të punësuar pranë këtyre bizneseve apo institucioneve që në fund të aktiviteteve e gjitha ty njihet edhe eksperiencë pune.	3.000.000 4.500.000

PJESËMARRJA DHE PËRFAQËSIMI RINOR NË POLITIKË DHE VENDIMMARRJE LOKALE

SITUATA AKTUALE	OBJEKTIVAT STRATEGJIK	INDIKATORË	AKTIVITETE	FINANCIM
Situtata e angazhimit të të rinjve në jetën politike në Përmet është thuajse inekzistente dhe në disa raste sporadike. Edhe pse nga ana e Bashkisë janë vendosur në dispozicion informacione e nevojshme sërish vihet re një mungesë e vullnetit të të rinjve për të marrë pjesë dhe për tu vetëpërfshirë në proceset e politikëbërjes dhe vendimmarrjes lokale. Kjo mungesë vullneti dhe besimi e të rinjve ka sjellë rrjedhimisht përjashtimin e tyre nga jeta politike duke e parë politikën si një punë për të rriturit dhe duke mos qenë ata protagonist të të ardhmes së tyre dhe komunitetit ku jetojnë. Forumet politike janë prezente por funksionojnë të mbyllura dhe aktivitetet e pakta që ata organizojnë realizohen në bazë të antarësisë dhe të mbyllura për një pjesëmarrje sa më të gjerë rinore. Të rinjtë shprehen të gatshëm në pjesëmarrjen e këtyre aktiviteteve nga forumet rinore politike por gjithnjë e më shumë atyre u kërkohet të jenë anëtarë të organizatave për të siguruar pjesëmarrjen.	1. Krijimi i rrjeteve rinore. 2. Përfshirja në mënyrë të barabartë dhe pa dallime gjinore, etnike apo sociale i grupimeve të të rinjve në mbledhjet e Këshillit Bashkiak dhe në vendimmarrje.	1) Takime informuese të realizuara me të rinjtë, trajnime të realizuara, numri i të rinjve pjesëmarrës në takimet informuese dhe trajnuese, pjesëmarrje në mbledhjet e Këshillit Bashkiak, fushata dhe pjesëmarrje në takime vendimmarrëse të hapura të Bashkisë. 2) Grupime rinore të krijuara, takime prezantuese të realizuara, numri i të rinjve pjesëmarrës në takime. 3) Aktivitete të realizuara me pjesëmarrjen e forumeve politike, të rinj të angazhuar në takime dhe në aktivitete.	1.1 Fushata informuese dhe trajnuese "Të rinjtë dhe politika, kujt i përket e ardhmja". Realizimi i sesioneve informuese mbi qeverisjen me pjesëmarrje, prezantim i të drejtave të komunitetit, ligjit të informimit, ligjit për funksionimin e pushtetit vendor si dhe njohja me funksionet dhe detyrat e Këshillit Bashkiak. 1.2 Trajnime mbi fushatat advokuese dhe lobuese e të rinjve për ti nxitur të marrin pjesë në vendimmarrjen lokale por edhe për të qenë ata nismëtarë vendimesh të ndryshme në dobi të komunitetit. Nxitja e krijimit të rrjeteve rinore jo-formale ose formale. Krijimi i rrjeteve apo grupimeve rinore duke i nxitur të rinjtë të kuptojnë rëndësinë e të qenurit të bashkuar dhe të vepruarit në grup. Realizim takimesh mbi best practice dhe modelet me të mira ose fushatat me të mira të ndërmara nga grupime rinore si dhe sukseset e arritura duke analizuar format e organizimit dhe aksionet e ndërmara. 1.3 Realizime aktiviteteve me forumet rinore politike. Nxitja e hapjes së forumeve politike dhe realizimi i aktiviteteve me pjesëmarrje edhe të të rinjve nga forumet e ndryshme politike por edhe nga të rinjtë të cilët nuk janë të angazhuar në forumet politike.	1.500.000 500.000 750.000



ARTI, SPORTI, KULTURA DHE MJEDISI

SITUATA AKTUALE	OBJEKTIVAT STRATEGJIK	INDIKATORË	AKTIVITETE	FINANCIM
Situatë e artit, sportit dhe kulturës në Bashkinë Përmet vitet e fundit ka pasur përmirësime të dukshme por megjithatë përfshirja në masë rinore nuk është në nivelet e kënaqshme. Të rinjtë gjithmonë e më shumë kanë nevojë të shprehin talentet e tyre dhe të kenë hapësira për ta realizuar aktivitetet dhe të promovohen. Mungesa e një ambienti rinor ose qendre rinore i ka penguar gjithmonë që ata të shprehin talentet e tyre. Restaurimi dhe ndertimi i ambienteve sportive por edhe kulturore si në shkollë por edhe jashtë ambienteve shkollore shikohet gjithnjë e më e vështirë pasi fondet e Bashkisë janë të pakta dhe të mjaftueshme thjesht sa për mirëmbajtjen e tyre. Realizimi i ekspozitave, aktiviteteve, konkurseve kulturore apo sportive me protagonist të rinjtë ka qenë gjithnjë e më shumë i vështirë kjo si pasojë e mungesës së ambienteve por edhe e mbështetjes financiare.	1. Ngritja e terreneve sportive brenda dhe jashtë ambienteve shkollore. 2. Promovim e talentëve në sport dhe art.	1) Qendër rinore e krijuar me parametra bashkëkohorë, pajisje dhe materiale të instaluar në ambientet e qendrës, evente promovuese të realizuara, të rinj që frekuentojnë ambientet e qendrës rinore, aktivitete të prodhuara nga të rinjtë.	1.1 Krijimi i një qendre rinore ose ambienti rinor në kushtet bashkëkohore dhe me pajisjet e nevojshme ku të rinjtë të shprehin talentet e tyre, të vetë organizohen dhe të prodhojnë aktivitete. Çaktimi në bashkëpunim me Bashkinë Përmet i një ambienti, ristaurimi dhe pajisja e tij me materialet e nevojshme. Promovimi i strukturës dhe funksionalitetit të saj.	4.000.000
		2) Ambiente sportive të ristauruara nëpër shkollë, numri i nxënësve që realizojnë aktivitete sportive, evente dhe gara sportive të realizuara në këto ambiente.	1.2 Ristaurimi i palestarve të shkollave dhe ambienteve sportive. Identifikimi i nevojave më urgjente në ambientet sportive shkollore dhe ristaurimi i tyre duke i kthyer në funksionalitet të plotë.	3.500.000
		3) Konkurse të realizuara, evente kulturore të realizuara, materiale të prodhuara nga të rinjtë, pjesëmarrje rinore nëpër konkurse, pjesëmarrje e komunitetit në evente dhe aktivitete, evente promovimi dhe material promovimi për të rinjtë e talentuar.	1.3 Organizim i konkurseve në pikturë, poezi dhe kampionateve sportive ndërmjet shkollave duke nxitur krijimtarinë dhe shpirtin e garës. Vlerësim dhe promovim i talentëve.	1.500.000
		4) Nisma të ndërmara nga të rinjtë në mbrojtjen e mjedisit, material të prodhuar në mbrojtjen e mjedisit, të rinj pjesëmarrës në nisma mjedisore.	1.4 Angazhim rinor në nismat për mbrojtjen e mjedisit dhe mbështetja e tyre në aktivitetet e ndërmara nga ata në mbrojtjen mjedisore dhe fushata ndërgjegjësimi mjedisore.	800.000

MBËSHTETJA E ORGANIZATAVE RINORE DHE NISMAVE RINORE

SITUATA AKTUALE	OBJEKTIVAT STRATEGJIK	INDIKATORË	AKTIVITETE	FINANCIM
Aktualisht në Bashkisë Përmet nuk operon dhe nuk është e regjistruar asnjë organizatë rinore. Gjithë puna rinore dhe përfshirja rinore e organizuar realizohet nëpërmjet organizatave që punojnë me rininë por si fokus të tyre kanë zhvillimin ekonomik të zonës dhe projektet rinore janë të pakta duke i kushtuar pjesës së rinisë një mbështetje financiare të pakët. Bashkia Përmet në buxhetin e saj të kufizuar e ka të pamundur të mbështesë financiarisht nismat rinore përtej programeve shkollore dhe aktiviteteve të programuar me pjesëmarrje rinore. Një mbështetje të veçantë nismat rinore kanë gjetur nga komuniteti i biznesit lokal ku çdo herë që të rinjtë kërkojnë mbështetje financiare në realizimin e nismave ata kontribuojnë duke i mbështetur. Dëshira dhe vullneti i të rinjve përmetar për të realizuar aktivitete dhe evente është i lartë por ky vullnet dhe kjo dëshirë pengohet gjithnjë e më shumë nga mbështetja financiare dhe pamundësitë e të rinjve për tu koordinuar dhe organizuar.	1. Nxitja e krijimit të organizatave rinore dhe mbështetja e nismave rinore.	1) Organizatë rinore e krijuar, numri i antarëve të organizatës, trajnime të realizuara mbi funksionalitetin dhe misionin e organizatave rinore.	1.1 Krijimi i një organizate rinore. Identifikimin i të rinjve virtuoze dhe të talentuar, trajnimi i tyre, organizimi, njohja e tyre me funksionalitetin dhe misionin e organizatave rinore, përcaktimi i të rinjve që duan të jenë pjesë e organizatës rinore dhe krijimi i saj duke ndarë detyrat sipas statutit.	200.000
		2) Trajnime të realizuara në formim kapaciteteve të organizatës, numri i antarëve pjesëmarrës në trajnime, projekt propozime të hartuara dhe dorëzuara pranë donatorëve të ndryshëm, evente promovimi dhe fundraising të realizuara, materiale promovuese dhe dokumeta strategjik të prodhuara.	1.2 Trajnime për capacity building dhe found raising të antarëve të organizatës dhe promovimi i organizatës. Do të realizohen trajnime në menaxhim financiar, menaxhim organizativ dhe në shkrim projektesh duke i pajisur të rinjtë me gjithë njohuritë e nevojshme që të arrijnë të përfitojnë projekte dhe financime nga donator të ndryshëm. Mbështetja me ekspertizë e organizatës në hartimin e projekt propozimeve të mundshme. Krijim i partneriteteve me organizata të tjera në paraqitje projekt propozimesh. Do të realizohet promovimi i organizatës në media sociale dhe media vizive duke publikuar gjithnjë aktivitete dhe evente ku organizata do të marrë pjesë. Realizim eventesh fundraising dhe promovim i organizatës.	1.500.000

ÇËSHTJET SOCIALE, SHËNDETËSORE DHE SHËRBIMET PUBLIKE

SITUATA AKTUALE	OBJEKTIVAT STRATEGJIK	INDIKATORË	AKTIVITETE	FINANCIM
Politikat sociale në Bashkinë Përmet mbështeten kryesisht në Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale dhe praktikisht dy nga institucionet Bashkia Përmet, nëpërmjet Zyrës së Çështjeve Sociale dhe Ndhmës Ekonomike si dhe Zyrës së Punës dhe Mbështetjes sociale. Organizma të tjera që ofrojnë asistencë sociale dhe mbështetje sociale nuk ka. Mbështetja sociale ndaj të rinjve dhe familjeve të tyre me probleme sociale është e pakët. Ka shumë të rinj me aftësi ndryshe të cilët nuk marrin trajtimin e nevojshëm apo edhe asistencën e nevojshme sociale. Mungojnë psikologët por edhe punonjësit social. Largësia e Përmetit më Tiranën ku veprojnë dhe realizojnë aktivitetet shumë të ndryshme organizatat sociale është e madhe dhe kjo përbën një pengesë që këto organizata të realizojnë aktivitete në Përmet. Puna sociale është thuajse një koncept i panjohur në Bashkinë Përmet dhe nevojat e ndërhyrjes janë të domosdoshme dhe imediate.	1. Politika sociale lokale dhe implementimi sa më efektiv i tyre. 2. Mbështetja e organizatave për çështjet sociale dhe puna sociale.	1) Mbështetja	1.1 Fushatë bamirësie dhe përkrahjeje sociale. Evente lokale dhe rajonale mbi krijimin dhe grumbullimin e fondeve sociale nga të rinjtë me mbështjen e institucioneve lokale duke gjeneruar fonde dhe ardhur në ndihmë familjeve në nevojë dhe me problem sociale.	500.000
			1.2 Realizimi i një politike afatgjatë sociale lokale duke u mbështetur në nevojat dhe problematikat lokale. Bashkërendim veprimesh midis institucioneve lokale, komunitetit, dhe QJF lokale për realizimin e një plani lokal mbi mbështetjen sociale.	1.500.000
			1.3 Përfshirja dhe realizimi i aktiviteteve me të rinjtë në zonat rurale. Realizimi i aktiviteteve në fshat, njohja me problematikat e të rinjve në zonat rurale.	850.000
			1.4 Fushata ndërgjegjësimi në kujdesin shëndetësor, seksual dhe droga. Realizimi i fushatave ndërgjegjëse dhe edukuese të shëndetit parësor në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetit Publik.	1.000.000



Jeta Qytetin Tënd

IV. ANALIZA SWOT

Analiza SWOT është një metodë planifikimi e strukturuar që përdoret gjerësisht për të evidentuar dhe vlerësuar Pikat e Forta (Strengths), Pikat e Dobëta (Weaknesses), Mundësitë (Opportunities) dhe Rreziqet/ Sfidat (Threats) të një projekti, çështjeje, territori, etj.

Gjatë hartimit të këtij Plani Veprimi, kjo metodë u përzgjedh si një instrument mjaft praktik dhe i dobishëm për të analizuar situatën ekzistuese, analizë mbi bazën e të cilës u hartuan qëllimet dhe objektivat strategjike. Pikat e dobëta dhe Pikat e forta evidentojnë çështje shqetësuese të të rinjve brenda territorit të Bashkisë Korçë, të cilat mund të adresohen nëpërmjet politikave vendore, ndërsa Mundësitë dhe Sfidat i përkasin aspekteve të jashtme, kontrolli i të cilave mund të kërkojë bashkëpunim ndërvendor apo angazhim të qeverisë vendore e më gjerë.

MONITORIMI DHE VLERËSIMI I SVR-së

Aktivitetet e monitorimit dhe vlerësimit janë një komponent thelbësor për të përmirësuar efektivitetin e vetëqeverisjes vendore. Monitorimi dhe vlerësimi siguron informacion mbi zbatimin e objektivave dhe programeve, që i mundëson Bashkisë Përmet të përfitojë nga sukseset dhe të mësojë nga eksperiencat e zbatimit. Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit kërkon përpjekje të përkushtuara, ekspertizë, aftësi, vlerësim dhe menaxhim të mirë. Ky proces konsiderohet si një nga më të rëndësishmit gjatë periudhës së zbatimit të një dokumenti strategjik, pasi shmang devijimet



nga përmbushja e objektivave të PLV 2020- 2023. Me qëllim që të sigurohet monitorim dhe raportim cilësor dhe i dobishëm, është e nevojshme që të përcaktohet si më poshtë vijon:

- Procesi i qartë i raportimit dhe i monitorimit me përgjegjësitë dhe kalendarin;
- Modelet dhe instrumentet që do të përdoren për monitorimin;
- Kapaciteti i strukturave kryesore dhe pjesëmarrëse.

Procesi i qartë i monitorimit dhe raportimit është i nevojshëm për të informuar pjesëmarrësit për përgjegjësitë e tyre dhe për t'u mundësuar atyre që të përgatiten për të gjitha angazhimet duke u bazuar në një kalendar të përcaktuar më parë. Sistemi i monitorimit duhet të jetë i mirëorganizuar për të ndjekur të gjitha hallkat që të mbulohen të gjitha projektet dhe të përcaktohen dhe konfirmohen strukturat monitoruese

Modelet dhe instrumentet janë të nevojshme për rrjetin e komunikimit mes strukturave dhe për të garantuar se paraqitja e informacionit është e pajtueshme dhe e lehtë për t'u konsoliduar. Udhëzimet se si të plotësohen modelet duhet të jenë të përgatitura në mënyrë të tillë që të jenë të lexueshme për të gjithë pjesëmarrësit. Përveç modeleve për elementë si objektivat do të jenë të nevojshme edhe sqarimet, sidomos në rastet kur vërehen vonesa apo mangësi për të detajuar elementët që sjellin devijime serioze. Informacioni i prodhuar përmes sistemeve të monitorimit dhe të raportimit mund të përdoret brenda Bashkisë Përmet për të marrë vendime dhe jashtë saj për të siguruar transparencë për publikun e gjerë.

Kapaciteti i strukturave për të prodhuar informacion cilësor dhe për të konsoliduar informacionin është shumë i rëndësishëm. Duhet përpjekje dhe aftësi për të prodhuar informacion raportimi të mirë të bazuar në analiza dhe të mbështetur nga prova. Praktika në sektorin publik tregon se shumë shpesh raportimi i informacionit fokusohet në veprimet e përditshme rutinore më shumë sesa në analizën e arritjeve. Kapaciteti mund të përmirësohet përmes udhëzimeve, trajnimit dhe praktikës.

Sistemi i monitorimit dhe i vlerësimit i propozuar përbëhet nga dy nivele:

I. Niveli i parë lidhet me monitorimin e projekteve duke

ndjekur me vëmendje arritjen e indikatorëve të përcaktuar në këtë dokument. Ky proces do të realizohet nga strukturat përgjegjëse brenda dhe në varësi të Bashkisë Përmet. Raportet e monitorimit të këtyre strukturave do të dërgohen tek struktura përgjegjëse për vlerësimin dhe jetësimin e prioriteteve në Bashki. Periodiciteti i monitorimit është vendosur bazuar në specifikat që ka çdo projekt.

II. Niveli i dytë lidhet me vlerësimin e përmbushjes së objektivave dhe rezultateve të pritshme. Ky vlerësim do të realizohet çdo fund viti, ku nëpërmjet analizës së raporteve të monitorimit do të vlerësohet masa e përmbushjes së objektivave, krahasimi i masës së arritjeve me masën e parashikuar, si edhe në raste të veçanta do të propozohen edhe ndryshime në projekte, kohëzgjatje, afate, fonde etj.

Monitorimi i PLV është fazë shumë e rëndësishme dhe matësi më i mirë i suksesit në zbatueshmërinë e saj. Puna do të nisë bazuar në procedurat administrative për të siguruar raporte mbi zbatimin e projekteve të ndryshme. Pastaj, gradualisht do të përmirësojmë cilësinë e informacionit të krijuar gjatë procesit dhe përfundimisht ky informacion do të përdoret në sistemin e vendimmarrjes.

Bazuar në kalendarin e monitorimit të strategjisë çdo vit do të përgatiten vlerësimet e ecures së PLV dhe do të raportohet tek Kryetari lidhur me ecurinë e punës për përmbushjen e objektivave strategjike. Në varësi të ecures së punës mund të propozohen edhe rishikime të objektivave strategjike. Në varësi të specifikave që kanë monitorimi/raportimi i projekteve do të kryehet në periudha 6-12 mujore. Raportet do t'i dërgohen strukturës përgjegjëse sipas afateve të përcaktuara. Vëmendje të veçantë i është kushtuar indikatorëve si sinjalizues të ecures së punës.

